



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Përkthim (B-A) (2)

Ngarkesa: 6 kredite, 20 leksione 40 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor “Përkthim Teknik – Letrar dhe Interpretim”;

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u japë studentëve njohuritë teorike dhe praktike mbi përkthimin e termave të specializuar nga fusha të ndryshme si politika, ligji, drejtësia, arti etj. Të zhvillojë aftësitë e studentëve në përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe teknologjike (glosarë, fjalorë, platforma CAT) për përkthim cilësor dhe profesional. Të krijojë një lidhje funksionale midis përkthimit dhe fushave të tjera përmes analizës stilistike, gjuhësore dhe kulturore të teksteve.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësojë studentët në përdorimin praktik të platformës TRADOS dhe përditësimin e bazës terminologjike MULTITERM gjatë përkthimit.
2. Të analizojnë dhe zbërthejnë tekstet përmes një qasjeje shumëdisiplinore, duke përdorur teoritë e përkthimit nga autorë si Holmes, Steiner, Nida dhe Koller.
3. Të eksplorojnë burime të ndryshme të termave (reklama, tekste teknike, interneti) dhe të pasurojnë fjalorin përmes krahasimit të përkthimeve manuale dhe atyre të asistuar nga teknologjia.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të

1. Kuptojnë dhe zbatojnë me saktësi konceptet kryesore të përkthimit terminologjik, përfshirë semantikën, ekuivalencën dhe analizën funksionale të tekstit.
2. Identifikojnë dhe përdorin me kompetencë terminologjinë përkatëse të fushave të specializuara gjatë përkthimit nga anglishtja në shqip.
3. Aplikojnë në mënyrë efektive platformën TRADOS dhe të përditësojnë vazhdimisht bazën e termave MULTITERM.